

VENDIM
Nr. 1122, datë 30.12.2020

**PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE, KUSHTEVE, PROCEDURAVE, FONDEVE TË
NEVOJSHME BUXHETORE PËR KRIJIMIN, MBAJTJEN, MENAXHIMIN DHE
PËRDITËSIMIN E KADASTRËS KOMBËTARE TË BURIMEVE UJORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 88, të ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar; të nenit 4, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”, dhe të nenit 26, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij vendimi është miratimi i kërkesave, kushteve, procedurave, fondeve të nevojshme buxhetore për krijimin, mbajtjen, menaxhimin dhe përditësimin e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore.

2. Të gjithë termat e përcaktuar në ligjin nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë vendim, ndërsa termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Administrator”, struktura pranë Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU), e ngarkuar për administrimin, menaxhimin, përditësimin dhe mirëmbajtjen e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore.

b) “Autoritet publik” janë:

i. organet e qeverisjes qendrore dhe vendore apo organet e tjera të administratës publike, përfshirë organizmat këshillues publikë, në nivel kombëtar, rajonal apo vendor;

ii. çdo person, fizik apo juridik, që ushtron funksione administrative publike, përfshirë edhe detyra, veprimtari ose shërbime specifike që kanë të bëjnë me mjedisin;

iii. çdo person juridik, që ka përgjegjësi a funksione publike apo që siguron shërbime publike, që kanë të bëjnë me aktivitete ose shërbime, në lidhje me ujërat dhe janë nën kontrollin e një organizmi apo personi që përfshihet në grupimet e përcaktuara në nënndarjet “i” dhe “ii”, të kësaj shkroneje.

c) “Baza e të dhënave shtetërore”, i njëjti kuptim, sipas përcaktimit në ligjin nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

ç) “Dataset”, grumbull të dhënash me karakteristika të lidhura logjike, duke përfshirë të dhënat e përpunuara.

d) “Dokument”, regjistrim i çdo lloji, forme dhe teknike (shkrim, të shtypura, imazhe, tinguj, film ose video, të dhënat elektronike etj., strukturën dhe përmbajtjen e të cilit e bën një entitet i veçantë.

dh) “Dokumentacioni teknik”, studim, projekt, plan, hartë, përshkrimi teknik dhe specifikime, udhëzime dhe dokument lidhur me objekte, pajisje, sistemet teknike dhe procedurat.

e) “Dhënësi i informacionit”, i njëjti kuptim, sipas ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

ë) “Gjenerues privat i të dhënave”, subjekte përdoruese të burimeve ujore, të cilët kanë në administrimin e tyre pajisje të matjeve hidrometeorologjike, të dhëna historike apo në kohë reale, të cilat duhet të përfshihen në Kadastrën Kombëtare të Burimeve Ujore.

f) “Informacion”, të dhëna të përpunuara, fotografi, vizatime, film, raporte, akte, tabela, grafikë, skica apo të tjera të përafërta, pavarësisht nëse është i ruajtur në një dokument apo jo,

dhe, pavarësisht nga burimi, data e origjinës, vendi i ruajtjes, mënyra e zbulimit me urdhrin e të cilit, në emrin e të cilit, për llogari të të cilit informacioni është i ruajtur.

g) “Informacioni i klasifikuar”, të dhëna, që nuk mund të shpërndahen për publikun e gjerë për shkak të kërkesave të konfidencialitetit, të sigurisë kombëtare apo çështje të tjera që kërkojnë nga ligji.

gj) “Kapaciteti maksimal gravitacional i derdhjes”, sasia maksimale e ujit që derdhet për shkak të gravitacionit dhe jo të pompimit apo të ndonjë forme tjetër.

h) “Kadastra”, Kadastra Kombëtare e Burimeve Ujore.

i) “Nyjat hidrografike”, nyjë, kryqëzime apo ndarje të rrjedhave ujore, brenda një rrjeti hidrografik.

j) “Pellgu zonal i ujërave nëntokësore/sipërfaqësore”, pellgu, i cili përfshin pellgje të tjera më të vogla.

k) “Pellgu natyror i supozuar”, pellgu natyror, i cili nuk është saktësisht i gjeometrizuar, por i përafrohet shumë pellgut të vërtetë natyror.

l) “Përrua”, ujërat sipërfaqësore natyrore në formën e një rrjedhe ujore natyrore.

ll) “Përrua sekondar”, përrua që derdhet në një përrua tjetër, ku ky i fundit derdhet direkt në lumë apo në ndonjë trup tjetër ujqor, liqen, det.

m) “Rrjedhë e sipërme lumore”, rrjedha e lumit mbi 800 (tetëqind) m nga kuota absolute/niveli i detit.

n) “Rrjedhë e mesme lumore”, rrjedha e lumit nga 200 (dyqind)–800 (tetëqind) m nga kuota absolute/niveli i detit.

nj) “Rrjedhë e poshtme lumore”, rrjedha e lumit më e vogël se 200 m nga kuota absolute/niveli i detit.

o) “Rrjedhë sekondare”, të gjitha rrjedhat që i shmangen drejtimit kryesor të rrjedhës në aksin e lumit ose kanalit.

p) “Sifon”, strukturë tubacioni që shërben për të përcjellë lëngje nga një nivel më i lartë në një nivel më të ulët, duke shfrytëzuar presionin diferencial që të detyrojë një kolonë lëngu të një niveli më të lartë para se të derdhet në dalje.

q) “Subjekt i interesuar”, i njëjti kuptim, sipas përcaktimit në ligjin nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

r) “Shtresa gjeohapësinore”, të dhënat gjeohapësinore të organizuara, sipas tipologjive të caktuara.

rr) “Të dhëna”, i njëjti kuptim, sipas përcaktimit të nenit 7, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, “Për bazat e të dhënave shtetërore”.

s) “Të dhëna gjeohapësinore”, të dhëna me një referencë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në një vend të veçantë ose zonë gjeografike.

sh) “Të dhëna gjeohapësinore të përcaktuara” janë një koleksion i identifikueshëm i të dhënave gjeohapësinore.

II. KËRKESAT DHE KUSHTET PËR KRIJIMIN DHE MBAJTJEN E KADASTRËS KOMBËTARE TË BURIMEVE UJORE

1. Kadastra krijohet e mbahet mbi bazën e të dhënave elektronike për burimet ujore, nëpërmjet sistemit dhe arkivit elektronik. Baza e të dhënave, e cila është përcaktuar në pikën 2, të nenit 88, të ligjit nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, strukturohet sipas strukturës së përcaktuar në pikën 2, të kreut II, të këtij vendimi.

2. Baza e të dhënave shtetërore për burimet ujore ndahet, për:

a) ujërat sipërfaqësore;

b) ujërat nëntokësore;

c) ujërat detare;

ç) strukturat e ujit;

d) përdorimi i ujit;

dh) mbrojtja e ujit;

- e) zonat e mbrojtura ujore;
 - ë) monitorimi i ujit;
 - f) monitorimi meteorologjik;
 - g) modele të tjera.
3. Kërkesat për modulën për trupat ujorë sipërfaqësorë, përfshirë ujërat detare, janë sipas shtojcës 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
4. Kërkesat për modulën për ujërat nëntokësore janë sipas shtojcës 2, që bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
5. Kërkesat për modulën për strukturat e ujit janë sipas shtojcës 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
6. Kërkesat për modulën për përdorimin e ujit janë sipas shtojcës 4, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
7. Kërkesat për modulën për mbrojtjen e ujit janë sipas shtojcës 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
8. Kërkesat për modulën për zonat e mbrojtura ujore dhe habitatet ujore janë sipas shtojcës 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
9. Kërkesat për modulën për monitorimin e ujit, janë sipas shtojcës 7, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
10. Kërkesat për modulën për monitorimin meteorologjik janë sipas shtojcës 8, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
11. Përcaktimet për hedhjen e të dhënave nga burimi i disponimit të tyre në Kadastër janë sipas shtojcës 9, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
12. Kadastra do të përmbajë të dhëna parësore/dytësore, sipas përcaktimit në nenin 7, të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore".
13. Në shtojcën nr. 9 të këtij vendimi janë përcaktuar institucionet që detyrohen të popullojnë Kadastrën me të dhëna, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, të dhëna parësore/dytësore, sipas përcaktimit të ligjit nr. 10325, datë 23.9.2010, "Për bazat e të dhënave shtetërore".

III. PROCEDURAT PËR MENAXHIMIN DHE PËR PËRDITËSIMIN E KADASTRËS KOMBËTARE TË BURIMEVE UJORE

1. Kadastra menaxhohet dhe përditësohet nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, nëpërmjet sistemit dhe arkivit elektronik.
2. Të gjitha të dhënat gjeohapësinore që përmban Kadastra do të vihen në dispozicion të ASIG-ut, sipas legjislacionit në fuqi.
3. Të gjitha institucionet, entet dhe subjektet e tjera, publike ose jopublike, që merren me menaxhimin e burimeve ujore, detyrohen të caktojnë një përfaqësues të përhershëm që mban marrëdhënie me Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore, duke raportuar në mënyrë periodike çdo 3 (tre) muaj mbi ecurinë e përditësimit me të dhënat në Kadastër. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore përgatit raportin në nivel kombëtar, të cilin ia paraqet Këshillit Kombëtar të Ujit me sugjerimet përkatëse.
4. Administrimi i Kadastrës kryhet nga Administratori, i cili kryen këto funksione:
 - a) është përgjegjës për sigurimin e vazhdueshmërisë së pandërprerë dhe mirëfunksionimin e Kadastrës;
 - b) mbikëqyr e monitoron veprimet që kryhen në Kadastër në përgjithësi;
 - c) është përgjegjës për strukturën e bazës së të dhënave dhe administrimin e saj;
 - ç) ka të drejtë të ndryshojë apo të anulojë nivelin e aksesit të një përdoruesi pa njoftim, kur vëren se ai nuk zbaton rregullat e përdorimit ose dyshohet se po i shkakton dëm sistemit në përgjithësi;
 - d) harton udhëzime dhe manuale për përdoruesit e sistemit;
 - dh) bën propozime për avancimin e programeve të përdorura dhe avancimin e sistemit në përgjithësi, në konsultim me Agjencinë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit;
 - e) krijon dhe administron nivelet e aksesit në Kadastër;

- e) krijon përdoruesit e të gjitha niveleve me privilegjet përkatëse për të punuar në sistem;
- f) shpërndan privilegjet për përdoruesit dhe u heq të drejtën për të punuar në sistem, në rast të largimit të tyre nga funksioni;
- g) krijon virtualisht institucionet në sistem, vendos varësitë, ndryshon varësitë e institucionit, fshin institucionin në rastin e mbylljes së tij dhe kalon të dhënat në arkivin historik;
- gj) monitoron dhe auditon mbledhjen, sistemimin, organizimin, koordinimin e të dhënave gjeohapësinore, grafike, elektronike, letër dhe të tjera lidhur me sektorin e ujërave, në një trajtë uniforme, efikase dhe të përgjegjshme;
- h) arkivon në mënyrë të sigurt dhe me metoda alternative të dhënat, si dhe ruan periodikisht kopje të të dhënave në mjedis rezervë, të shkëputur e të pavarur nga sistemi kryesor; përmbush detyrimet për shkëmbimin dhe hyrjen në informacion;
- j) krijon mundësinë e gjenerimit të raporteve nga sistemi në institucionet e administratës publike, sipas nevojave të tyre.

5. Dhënia e informacionit/dhënësit e informacionit për Kadastrën u nënshtrohen këtyre përcaktimeve:

a) të gjitha institucionet shtetërore, autoritetet dhe entet publike, subjektet fizike dhe juridike, vendës e të huaj, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë dhe aktivitetit që ato zhvillojnë në fushën e ujërave, detyrohen të regjistrohen si të tillë në Agjencinë e Menaxhimit të Burimeve Ujore dhe të popullojnë e përditësojnë Kadastrën me të dhënat që ata disponojnë në këtë fushë. Të dhënat hidhen në mënyrë periodike, në standardin e kërkuar, në përputhje me rregullat e përcaktuara në këtë vendim;

b) të gjithë përdoruesit e burimeve ujore, subjekte private apo subjekte juridike me kapital shtetëror, të cilët, me financimin dhe infrastrukturën e tyre, disponojnë e përpunojnë të dhëna që janë pjesë e atributëve të Kadastrës, janë të detyruar t'i hedhin këto të dhëna në Kadastrë. Ndërveprimi dhe procesi i ndërveprimit ose i shkëmbimit të të dhënave ndërmjet bazave të të dhënave realizohet përmes platformës qeveritare të ndërveprimit;

c) të gjitha hidroelektrocentralet (HEC) e ndërtuara, përpara hyrjes në fuqi të këtij vendimi apo të planifikuar për t'u ndërtuar, duhet që:

i. në secilën nga veprat e marrjes, prurja llogaritëse e të cilave është më e madhe se 150 l/sek, të instalojnë një stacion hidrologjik, automatik, që mat prurjet e nivelet ditore me një frekuencë 2 (dy) herë në ditë;

ii. pranë godinës së centralit, të instalojnë një stacion meteorologjik, automatik, i cili mat të paktën temperaturën, reshjet dhe lagështinë, me frekuencë ditore.

Brenda datës 30.6.2021, subjekti duhet të njoftojë AMBU-në për të verifikuar instalimin e këtyre stacioneve dhe funksionalitetin e tyre në kuptim të gjenerimit e transmetimit të të dhënave, në përputhje me përcaktimet e neneve 53 e 72, të ligjit nr. 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar.

Të dhënat e gjeneruara, sipas nënndarjes "i", të kësaj shkronje, dërgohen në kohë reale në IGJEUM dhe AMBU. Në pamundësi të kësaj mënyre, të dhënat mujore të digjitalizuara dërgohen çdo datë 1 të muajit pasardhës, në formë elektronike, pranë IGJEUM-it dhe AMBU-së;

ç) në rastet kur një subjekt i interesuar ndërron statusin e tij, ai është i detyruar të bëjë çregjistrimin e tij me shkrim pranë Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore;

d) lista e dhënësve të informacionit në Kadastrë përditësohet në mënyrë të vazhdueshme nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore;

dh) detyrimet e dhënësit të informacionit të Kadastrës konsistojnë, në:

i. saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave e informacioneve në fushën e menaxhimit të ujit, me anë të kontrollit të afateve kohore, si dhe për të konfirmuar cilësinë e tyre;

ii. hartimin e zbatimin e procedurave për menaxhimin e të dhënave/informacionit (përgatitjen, inputet, përditësimin, përpunimin, prezantimin, disponueshmërinë);

iii. mundësimin e të dhënave të përputhshmërisë dhe grumbullimin e të dhënave gjeohapësinore, grafike, elektronike, letër e të tjera dhe shërbimet e informacionit;

iv. detyrimin për hyrjen dhe shkëmbimin e informacionit;
v. respektimin e të gjitha standardeve në fuqi të legjislacionit shqiptar në fushën e informacionit gjeohapësinore;

e) në rastet kur dhënësi i informacionit nuk realizon në kohë kompletimin ose pengon futjen e të dhënave në Kadastrë me të dhënat e përshkruara më lart apo të dhëna të tjera lidhur direkt/indirekt me ujin, ai mban përgjegjësi administrative, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Në këto raste, mbi bazën e njoftimit zyrtar të dërguar nga titullari i Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, institucioni përkatës nis procesin, ku shqyrtohet përgjegjësia administrative e personit përgjegjës;

ë) mosrespektimi i detyrimeve dhe i afateve të përcaktuara në shkronjat “b” dhe “c”, të kësaj pike, bën pjesë në mospërmbushjen e kushteve të lejes për përdorimin e burimit ujor dhe shoqërohet me masat administrative që përcakton ligji nr. 111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, i ndryshuar;

f) të drejtën e përdorimit të të dhënave dhe informacioneve lidhur me aktivitetet që nuk kanë përfunduar e kanë:

- i. personat përgjegjës të përfshirë në aktivitete të tilla;
- ii. personat që mbikëqyrin personin tjetër të autorizuar;

g) nëse të dhënat që disponohen nuk plotësojnë kërkesat për nga përmbajtja dhe standardi, nga institucionet përkatëse, brenda muajit mars të çdo viti, bëhet vlerësimi i nevojave teknike dhe financiare për të plotësuar këto kërkesa, në përputhje me Kadastrën. Këto kërkesa paraqiten si pjesë e kërkesave buxhetore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe një kopje e relacionit përkatës i dërgohet zyrtarisht edhe Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore;

gj) AMBU-ja përgatit programin vjetor të monitorimit, ku adreson të gjitha nevojat e paraqitura nga institucionet monitoruese dhe ato që evidentohen nga raporti vjetor i përditësimit të Kadastrës.

6. Niveli i aksesimit për institucionet, entet publike e private dhe subjektet përdoruese të burimeve ujore, të cilat popullojnë me të dhëna Kadastrën, u nënshtrohet këtyre përcaktimeve:

a) hyrja në të dhëna dhe informacioni për menaxhimin e burimeve ujore është:

- i. hyrje e drejtpërdrejtë në burim;
- ii. kopjim i të dhënave;
- iii. marrja e një informacioni të përpunuar;

b) të dhënat dhe informacionet e hedhura të jenë në formë elektronike;

c) të drejtën për hedhjen e të dhënave dhe informacioneve në Kadastrë e kanë punonjësit e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, si dhe autoritetet e tjera publike, në përputhje me nivelin e lejuar nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore;

ç) dhënësi i informacionit cakton personin përgjegjës, që do të ketë të drejtën e detyrimin e hedhjes së të dhënave në Kadastrë. Ky person pajiset me të drejtën e përdoruesit nga administratori i Kadastrës. Autentifikimi në Kadastrë do të realizohet ndërmjet integritetit me platformën *Single Sign On* të AKSHI-t;

d) Institucioni që posedon informacionin përkatës, duhet të vërë në dispozicion këtë informacion, në kohën e duhur, në çdo rast të kërkuar nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore.

7. Shkëmbimi i informacionit/ndërveprimi me bazat e tjera të të dhënave realizohet sipas këtyre përcaktimeve:

a) kadastra përfshihet në GIS-in kombëtar dhe publikohet në Gjeoportalin Kombëtar të administruar nga ASIG-u, sipas procedurave dhe rregullave të përcaktuara në ligjin nr. 72/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë”, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij;

b) informacioni nga Kadastra shkëmbehet dhe përdoret pa pagesë ndërmjet institucioneve shtetërore publike;

c) për rastet e paparashikuara në këtë vendim, informacioni nga Kadastra shkëmbehet dhe përdoret ndërmjet institucionit shtetëror dhe enteve ose subjekteve joshtetërore, në përputhje me marrëveshjet e ndërsjella;

ç) informacioni në dispozicion të personave fizikë dhe juridikë, vendës apo të huaj, është i hapur, i dukshëm, i papërpunueshëm dhe i pashkarkueshëm;

d) dhënësit e informacionit mund të japin të dhëna dhe informacione vetëm brenda kufijve të kompetencave të tyre.

8. Informacioni i klasifikuar apo informacionet, të cilat nuk janë në dispozicion për subjekte të tjera, janë:

a) informacioni i cilësuar si i klasifikuar, mbështetur në legjislacionin në fuqi;

b) informacioni i dhënë nga kompanitë dhe individët, të cilët kanë kërkuar fshehtësinë apo kufizim në përdorim të njëjtë, për arsye të sekretit profesional dhe mbrojtjes së të dhënave personale, sipas legjislacionit në fuqi.

9. Përditësimi i Kadastrës bëhet, si më poshtë vijon:

a) autoritetet përgjegjëse, për çdo modul të bazës së të dhënave, sipas fushës së tyre të përgjegjësisë, do të bëjnë rregullisht përditësimet e të dhënave çdo muaj;

b) të gjitha përditësimet, mbas hedhjes për herë të parë të të dhënave, duhet të kryhen të paktën katër muaj pas aplikimit të ndryshimit të grupeve të të dhënave burimore, pavarësisht se për përditësimet e të dhënave të menaxhimit të burimeve ujore specifike janë caktuar periudha të ndryshme në standardet përkatëse të temës.

IV. FONDET BUXHETORE DHE DISPOZITAT E FUNDIT

1. Mirëmbajtja dhe përmirësimi i sistemit elektronik mbulohen nga fondet e miratuara në buxhetin për institucionin e ngarkuar me përgjegjësi për administrimin e këtij sistemi (AKSHI).

2. Ngarkohen Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, institucionet publike që përcaktohen në këtë vendim dhe në shtojcat e tij, subjektet private dhe subjektet juridike me kapital shtetëror për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA 1

KËRKESAT PËR MODULIN PËR TRUPAT UJORË SIPËRFAQËSORË DHE UJËRAT DETARE

1. Moduli për trupat ujorë sipërfaqësorë dhe detarë përbëhet nga shtresa gjeohapësinore të lidhura me një tabelë përkatëse të attributeve. Tabelat e attributeve përmbajnë identifikues unik, kodet kombëtare dhe të BE-së, emrat dhe përshkrimin e saktë të trupave ujorë sipërfaqësorë.

2. Shtresat gjeohapësinore dhe përshkrimet e tyre specifike për ujërat sipërfaqësore janë të dhënat, si më poshtë:

a) baseni lumor;

b) basenet ujore;

c) nënbasenet;

d) nënpellgjet;

e) nyjat hidrografike;

f) liqenet dhe segmentet liqenore;

g) lumi, zona të lumit apo segmente të kanalit;

h) ujëmbledhësit.

3. Baseni lumor, nënpellgjet, ujëmbledhësit dhe basenet ujore dhe nënbasenet përshkruhen sipas tipit.

4. Baseni lumor, nënpellgjet, ujëmbledhësit dhe basenet ujore janë të dhëna të cilat përshkruhen sipas:

- a) llojit;
- b) pellgut natyror;
- c) pellgut natyror të vërtetë/të supozuar;
- d) sipërfaqes së pellgut;
- e) sipërfaqes së pellgut të supozuar;
- f) pellgut të njëtrajtshëm ose të papërcaktuar/supozuar të ujërave nëntokësore;
- g) pellgut të njëtrajtshëm ose të papërcaktuar/supozuar të ujërave sipërfaqësore;
- h) pellgut zonal të ujërave nëntokësore;
- i) pellgut zonal të ujërave nëntokësore të papërcaktuar/supozuar;
- j) origjinës;
- k) rendit.

5. Liqeni dhe segmentet liqenore përshkruhen nga:

- a) volumi ujëmbledhës;
- b) vetëm gjatë dhe/ose menjëherë pas rritjes së konsiderueshme të volumit ujëmbledhës;
- c) gjatë dhe menjëherë pas mbajtjes së volumit ujëmbledhës për një pjesë të vitit;
- d) në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit;
- e) i panjohur;
- f) sipas zonës në km^2 ;
- g) sipas llojit të ujit të ndenjtur;
- h) akumulimit dhe zonës së mbajtjes;
- i) liqenet dhe ujërat e tjera të ndenjtura;
- j) rezervuar;
- k) uji në strukturat artificiale;
- l) sipas historisë.

6. Sipas klasës dhe sipërfaqes, liqenet ndahen në:

- a) shumë të vegjël deri në $0,499 \text{ km}^2$;
- b) të vegjël $0,5$ në $0,999 \text{ km}^2$;
- c) të mesëm 1 deri në $9,999 \text{ km}^2$;
- d) të mëdhenj 10 deri në $99,999 \text{ km}^2$;
- e) shumë të mëdhenj më shumë se 100 km^2 ;
- f) nga vëllimi në m^3 .

7. Lumenjtë/kanalet janë të ndara në segmente, që shtrihen nga burimi deri në kontribues të parë, në mes të dy degëve fqinje, si dhe në mes të kontribuesit të fundit dhe grykëderdhjes.

8. Lumenjtë ndahen, gjithashtu, në vendet ku ekziston një ndryshim dëshmuar për ndonjë nga karakteristikat përkatëse, të tilla si: ndryshime të rëndësishme hidrologjike dhe morfologjike, p.sh. lumë i lundrueshëm, gjendjes së ujit dhe cilësisë së ujit, sasisë së prurjeve, rrjedhjes vjetore, rrjedhës së kthyer etj.

9. Lumenjtë përshkruhen sipas nënpellgut ku janë vendosur.

10. Përcaktimi, nëse është lumë ose kanal, bëhet sipas kategorisë së madhësisë:

- a) lumenj/kanale shumë të vogla më pak se 10 km^2 ; ose
- b) lumenj/kanale të vogla ose zona ujëmbledhëse prej 10 km^2 deri në 500 km^2 ;
- c) lumenj/kanale ose zona e mbulimit prej 500 km^2 deri në 1000 km^2 ;
- d) lumenj/kanale të mëdhenj ose zona ujëmbledhëse prej 1000 km^2 deri në 4000 km^2 ;
- e) lumenj/kanale kryesore ose zona të mbulimit më të mëdha se 4000 km^2 .

11. Sipas kategorisë së shtrirjes lumi/kanali klasifikohet në:

- a) lumë/kanal normal;
- b) lumë/kanal më i madh në nivel rrethi të basenit të lumit;
- c) lumë/kanal më i madh në nivel nënpellgu ose lumi i rëndësishëm në nivel rrethi të basenit të lumit;

- d) lumë/kanal i zgjedhur në nivel nënpellgu;
- e) lumë/kanal i panjohur.
- 12. Lumenjtë ose segmentet e kanaleve përshkruhen nga:
 - a) regjimi i rrjedhës:
 - i. vetëm gjatë reshjeve me intensitet të lartë (brenda 2 orësh sasia prej 50 mm);
 - ii. vetëm menjëherë pas reshjeve me intensitet të lartë;
 - iii. gjatë reshjeve;
 - iv. pas reshjeve;
 - v. për një pjesë të vitit, në mënyrë të vazhdueshme gjatë vitit, i panjohur; me drejtimin e rrjedhjes; me gjatësi; duke caktuar pikën e segmentit të lumit në km në fillim deri në fund pikën e segmentit të lumit në km;
 - b) tipi i lumit ose i kanalit:
 - i. lumë apo kanal kryesor;
 - ii. rrjedhë lumore sekondare;
 - iii. përrenj;
 - iv. përrenj sekondarë ose rrjedhje në lumë;
 - v. lumë në rrjedhjen e mesme ose lidhje me lumin;
 - vi. kanal kullimi dhe ujitje apo kanal tjetër;
 - vii. rrjedhjet e tjera;
 - viii. kanal furnizimi/kullimi në formë tuneli;
 - ix. rrjedhë kryesore përmes liqenit - lidhje kryq rrjedhjes;
 - x. lumë ose lidhje me lumin;
 - xi. kryq rrjedhjes;
 - c) vazhdimësia:
 - lidhje që ruajnë tipologjinë e rrjetit:
 - i. shtrirja e vërtetë e lumit;
 - ii. i panjohur;
 - ç) kufijtë:
 - i. shteti;
 - ii. nivelit të parë të subjekteve administrative në një shtet;
 - iii. nivelin e dytë të subjekteve administrative në një shtet;
 - iv. nivelin e tretë të subjekteve administrative;
 - v. nivelin e katërt të subjekteve administrative;
 - vi. segmenti i lumit nuk është pjesë e çfarëdo kufijve natyralë;
 - d) karakterizimi i shtrirjes së lumit;
 - i. nga historia;
 - ii. nga segmenti i lumit ku fillojnë nyja;
 - iii. segmente të lumit;
 - iv. nyja fundore;
 - dh) njësitë kalimtare të ujit:
 - i. sipërfaqja në km²;
 - ii. lidhja e ujërave nëntokësore:
 - e vërtetë;
 - e supozuar;
 - e panjohur;
 - e) lidhja e lumenjve me zonat e mbrojtura:
 - i. e vërtetë;
 - ii. e supozuar;
 - iii. e panjohur;
 - iv. nga në-pellgu ku është vendosur;
 - ë) njësitë bregdetare të ujit, si:

- i. lagunat bregdetare;
- ii. kënetat;
- iii. moçalet;
- iv. deltat e lumenjve;
- v. rezervuarët artificialë bregdetarë;
- vi. porte dhe limane të ndërtuara në tokë dhe që komunikojnë me detin.

f) njësitë bregdetare të ujit ndahen sipas:

- i. sipërfaqja në km²;
- ii. lidhja me ujërat nëntokësore:

- e vërtetë;
- e supozuar;
- e panjohur.

iii. lidhja me zonat e mbrojtura:

- e vërtetë;
- e supozuar;
- e panjohur.

iv. nënpellgu ku është vendosur.

g) ujërat territoriale:

- i. sipërfaqja në km²;
- ii. nga lidhja me zonat e mbrojtura:

- e vërtetë;
- e supozuar;
- e panjohur.

13. Nyjat hidrografike janë nyje brenda një rrjeti hidrografik, të cilat mund të përfaqësojnë një pikë fizike bashkimi/degëzimi/mbyllje etj. ose mund të lidhen me një pikë hidrografike interesi apo objekti. Nyjat hidrografike përshkruhen, sipas:

- a) kategorisë;
- b) emërimit gjeografik;
- c) hidroidentifikuesve;
- i. skema e klasifikimit;
- ii. ID-ja lokale;
- iii. emri lokal.

SHTOJCA 2 KËRKESAT PËR MODULIN PËR UJËRAT NËNTOKËSORE

1. Moduli për ujërat nëntokësore përbëhet nga shtresa gjeohapësinore të lidhura me një tabelë përkatëse të attributeve. Tabelat e attributeve përmbajnë identifikues unikë, kodet (kombëtare dhe të BE-së), emrat dhe përshkrimin e saktë të ujërave nëntokësore. Tabelat e attributeve janë të lidhura me një dokumentacion teknik aty ku është e përshtatshme.

2. Shtresat gjeohapësinore dhe përshkrimet e tyre specifike janë të dhëna, të cilat përshkruhen, si:

- a) pikat e burimeve natyrale; dhe
- b) të dhënat e përgjithshme të burimeve natyrale.

3. Burimet ujore natyrale klasifikohen nga institucionet përgjegjëse (Shërbimi Gjeologjik Shqiptar) dhe Instituti i Gjeoshkencave, si më poshtë:

3.1 Sipas fenomenit dhe tipit të burimit:

- a) burime çarjesh hipës ose zbritës;
- b) burime shtresore hipës ose zbritës;
- c) burime karstike;
- d) burime të prishjeve tektonike;

- e) burime të kontaktit litologjik;
 - f) burime jokarstike;
 - g) burimet nëndetar.
- 3.2 Sipas vendndodhjes gjeografike (koordinatat);
- a) me gjatësi;
 - b) me gjerësi;
 - c) me lartësi.
- 3.3 Sipas llojit të ujit:
- a) ujë i ëmbël ose i freskët;
 - b) ujë i kripur;
 - c) ujë me kripshmëri detare;
 - d) ujë i shëllirtë;
 - e) ujë mineral;
 - f) ujë termal;
 - g) ujë radioaktiv;
 - h) ujë termomineral.
- 3.4 Sipas llojit të burimit:
- a) zbritës;
 - b) ngjitës;
 - c) bregdetarë.
- 3.5 Sipas llojit të fenomeneve:
- a) i infiltruar (dekantuar në nëntokë);
 - b) dalës i koncentruar;
 - c) dalës i shpërndarë;
 - d) gufim;
 - e) liqen;
 - f) shpellë;
 - g) sipas tipit të rrjedhjes;
 - h) kontakt;
 - i) depërtim;
 - j) dalës nga shtrati;
 - k) gjatësi e daljes;
 - l) zona e mbarimit të rrjedhjes;
 - m) nga thellësia e burimit nëndetar;
 - n) nga kapaciteti kryesor;
 - o) nga minimumi i kapaciteteve;
 - p) nga maksimumi i kapaciteteve.
- 3.6 Sipas regjimit të rrjedhjes së ujit:
- a) i panjohur;
 - b) i përhershëm;
 - c) i përkohshëm.
- 3.7 Sipas strukturës së marrjes së ujit:
- a) i kaptazhuar;
 - b) i pakaptazhuar ose i panjohur;
 - c) rezervuar për furnizimin me ujë.
- 3.8 Sipas llojit të strukturës së konsumit:
- a) kaptazhimi i burimit;
 - b) galeria e ujit;
 - c) nga pellgu dhe nënpellgu ku është vendosur.
4. Pikat e shpimeve, të dhënat e përgjithshme, të dhënat hidrogeologjike, litologjike dhe dokumentet.

4.1 Pikat e shpimeve dhe të dhënat e përgjithshme janë përshkruar nga institucionet përgjegjëse (Shërbimi Gjeologjik Shqiptar) si objekte të shpuara:

- a) pusët;
- b) shpimet;
- c) piezometrat.

4.2. Sipas llojit të objektit të shpuar:

- a) pusët e testimit dhe shfrytëzimit;
- b) pusët e furnizimit me ujë të pijshëm;
- c) pusët termomineral;
- d) pusët e gërmuara;
- e) pus-shpimeve gjeologjike;
- f) pus-shpimeve hidrogeologjike;
- g) pus-shpimeve gjeologo-inxhinierike;
- h) pus-shpimeve gjeoteknike;
- i) pusët e kullimit;
- j) pusët e konsolidimit;
- k) puse nafte;
- l) puse gazi;
- m) puse me qëllim të veçantë;
- n) nga emri i objektit të shpimit;
- o) nga gjatësia;
- p) nga gjerësia;
- q) nga lartësia;
- r) nga thellësia e tubacionit;
- s) nga saktësia e vendndodhjes;
- t) nga thellësia e shpimit;
- u) nga diametri i shpimit;
- v) nga mënyra e shpimit;
- w) nga interpretues të shpimit;
- x) sipas vitit të shpimit;
- y) nga viti i rikonstruksionit;
- z) nga pellgu dhe nënpellgu ku është vendosur.

5. Të dhënat e shpimeve hidrogeologjike janë përshkruar:

5.1 Nga poroziteti i akuiferit:

- a) ndërkokrrizor;
- b) frakturor;
- c) çarje-pore;
- d) ndërkokrrizor dhe çarje;
- e) çarje dhe çarje-pore.

5.2 Sipas llojit të akuiferit:

- a) të hapur;
- b) të mbyllur;
- c) gjysmë të mbyllur.

5.3. Sipas llojit të ujit:

- a) ujë i freskët;
- b) ujë mineral;
- c) ujë termal;
- d) ujë nëntermal;
- e) termominerale;
- f) të njelmët;
- g) të freskëta-njelmët;

h) i kripur.

5.4 Sipas karakteristikave të shpimit dhe akuiferit:

- a) nga thellësia e tavanit të akuiferit;
- b) nga thellësia e tabanit të akuiferit;
- c) nga kapaciteti individual i shpimit/burimit;
- d) nga të dhënat e veçanta;
- e) nga ujë përshkueshmëria hidraulike;
- f) nga ujëpërcjellshmëria;
- g) nga ruajtja e veçantë;
- h) nga filtrimi;
- i) nga rrezja efektive e puseve;
- j) nga metoda e përcaktuar për shpimin me rrotullim/goditje;
- k) nga testi i pompimit;
- l) nga analizat granulometrike;
- m) nga mënyra e shpimit - karotash.

5.5 Sipas litologjisë së shpimeve:

- a) intervali;
- b) gjatësia e intervalit;
- c) përshkrimi litologjik;
- d) simboli litologjik.

5.6 Sipas të dhënave për shpimet e bëra:

- a) thellësia e shpimit;
- b) nga thellësia e fundit të shpimit;
- c) nga diametri i tubove.

5.7 Sipas instalimeve në shpim:

- a) tubat;
- b) filtrat;
- c) pjesa fundore e mbyllur e konstruksionit të pusit.

5.8 Sipas materialit ndërtimor:

- a) çelik;
- b) plastikë;
- c) hekur;
- d) hekur i galvanizuar;
- e) azbest;
- f) çimento;
- g) inoks;
- h) e kombinuar.

5.9 Sipas llojit të filtrit:

- a) tub i hapur;
- b) tub me vrima;
- c) vrima me rrjetë;
- d) çarje të hapura;
- e) çarje me rrjetë;
- f) spirale (të mbështjellë).

5.10 Sipas dokumenteve të shpimeve:

- a) formati i dokumentit;
- b) përshkrimi i dokumentit;
- c) arkivi dhe nga numri arkivor.

6. Pikat e gërmuara, të dhënat e përgjithshme për gërmimet, të dhënat hidrogeologjike dhe dokumentacioni.

6.1 Pikat e gërmuara dhe të dhënat e përgjithshme përshkruhen nga institucioni përgjegjës (Shërbimi Gjeologjik Shqiptar), si:

- a) objekte të gërmuara;
- b) puse të gërmuara;
- c) galeri të marrjes së ujit;
- d) nga emri.

6.2 Sipas vendndodhjes:

- a) gjerësia;
- b) gjatësia;
- c) lartësia;
- d) vendndodhja e saktë - koordinatat;
- e) thellësia;
- f) diametri.

6.3 Sipas llojit të hyrjes:

- a) pjerrësia;
- b) pusi kryesor i minierës;
- c) miniera;
- d) prerje;
- e) nga gjatësia e hyrjes;
- f) tipi i nxjerrjes së ujit;
- g) galeri;
- h) galeri e pjerrët;
- i) pusi kryesor i minierës;
- j) pus i pjerrët;
- k) pus horizontal;
- l) pus vertikal;
- m) nga gjatësia e marrjes së ujit (nënkupton tubacionin);
- n) nga azimuti i marrjes së ujit;
- o) nga numri i objekteve të marrjes së ujit të futura (stacionet e pompimit);
- p) nga distanca midis objekteve të marrjes së ujit (të futura);
- q) nga tipi i gërmimit;
- r) nga viti i gërmimit;
- s) nga pellgu dhe nënpellgu ku është vendosur.

7. Të dhënat hidrogeologjike të objekteve të gërmuara përshkruhen:

7.1 Nga poroziteti i akuiferit, si:

- a) ndërkokrrizor;
- b) frakturor;
- c) çarje;
- d) poro-çarje;
- e) çarje-pore;
- f) ndërkokrrizor dhe çarje.

7.2 Sipas llojit të akuiferit:

- a) të hapur;
- b) të mbyllur;
- c) gjysmë të mbyllur.

7.3 Sipas llojit të ujit:

- a) ujë i freskët;
- b) ujë mineral;
- c) ujë termal;
- d) ujë nëntermik;
- e) ujë termomineral;

- f) ujë i njelmët;
- g) ujë i freskët - i njelmët;
- h) ujë i kripur.

7.4 Sipas të dhënave të tjera:

- a) nga kapaciteti individual;
- b) nga të dhënat e veçanta;
- c) nga akumulimi i veçantë;
- d) nga ujëpërshkueshmëria hidraulike;
- e) nga ujëpërcjellshmëria;
- f) nga filtrimi;
- g) nga analiza granulometrike;
- h) nga rrezja efektive e puseve;
- i) nga testi i pompimit;
- j) nga metoda e përcaktuar për tipin e shpimit me rrotullim/goditje;
- k) nga metoda e shpimit-karotash.

7.5 Sipas dokumenteve të gërmimeve:

- a) formati i dokumentit;
- b) përshkrimi i dokumentit;
- c) nga arkivi dhe nga numri arkivor.

8. Pikat geomorfologjike, të dhëna të përgjithshme dhe dokumentacioni përshkruhen nga institucionet sipas fushës së përgjegjësisë.

8.1 Pikat geomorfologjike dhe të dhënat e përgjithshme janë përshkruar nga tipologjia:

- a) emri;
- b) vendndodhja;
- c) koordinatat gjeografike; me gjatësi; me lartësi të hyrjes; me saktësi të vendndodhjes;
- d) numri i hyrjes;
- e) dimensionimi i hyrjes kryesore;
- f) gjatësia e gjurmës; nga thellësia;
- g) ndryshimi i lartësisë;
- h) azimuti i objektit;
- i) thellësia në ujë.

8.2 Sipas llojit të regjimit:

- a) të panjohur;
- b) të përherëshëm;
- c) të përkohshëm;
- d) të reja.

8.3 Sipas regjimit të uljes së nivelit të ujit:

- a) të panjohur;
- b) të përherëshëm;
- c) të përkohshëm;
- d) të reja.

8.4 Sipas rrjedhës jashtë regjimit:

- a) të panjohur;
- b) të përherëshëm;
- c) të përkohshëm;
- d) të reja.

8.5 Sipas llojit të ujit:

- a) ujë i freskët;
- b) ujë mineral;
- c) ujë termal;
- d) ujë nëntermike;

- e) ujë termomineral;
- f) ujë i njelmët;
- g) ujë i freskët – i njelmët;
- h) ujë i kripur;
- i) nga pellgu dhe nënpellgu ku është vendosur.

8.6 Sipas dokumenteve gjeomorfologjike:

- a) formati i dokumentit;
- b) nga përshkrimi i dokumentit;
- c) nga arkivi dhe nga numri arkivor.

9. Njësitë e ujërave nëntokësore dhe njësitë e inerteve nëntokësore.

9.1 Ujërat nëntokësore përshkruhen sipas ekorajoneve, si:

- a) ndërkufitar;
- b) nga jashtë rrethit të basenit lumor;
- c) nga jashtë rrethit të nënbasenit lumor;
- d) nga emri;
- e) nga gjerësia;
- f) nga gjatësia;
- g) sipas sipërfaqes;
- h) nga horizonti i ujërave nëntokësore;
- i) përcaktimi i formës finale;
- j) nga kapaciteti.

9.2 Klasifikimi sasior i ujërave nëntokësore:

- a) më pak se 1000 km²;
- b) midis 1000 km² dhe 4000 km²;
- c) më shumë se 4000 km²;
- d) nga lidhja me ujërat sipërfaqësore;
- e) nga lidhja me zonat e mbrojtura.

9.3 Njësitë e inerteve nëntokësore janë përshkruar nga:

- a) emri;
- b) sipas fushave;
- c) gjerësia;
- d) gjatësia;
- e) kapaciteti;
- f) shtresat e trupave ujorë nëntokësorë;
- g) klasa e madhësisë së shtresave nëntokësore;
- h) më pak se 1000 km²;
- i) në mes të 1000 km² dhe 4000 km²;
- j) më shumë se 4000 km²;
- k) lidhja shoqëruese me ujërat sipërfaqësore;
- l) lidhja shoqëruese me zonat e mbrojtura.

SHTOJCA 3

KËRKESAT PËR MODULIN PËR STRUKTURAT E UJIT

1. Moduli për strukturat e ujit përbëhet nga dy shtresa gjeohapësinore:

- a) strukturat gjatësore të ujit/objekteve; dhe
- b) strukturat tërthore të ujit/objekteve.

2. Tabela e attributeve të strukturave gjatësore të ujit përshkruan të dhënat e përgjithshme dhe specifike.

2.1 Tabela e attributeve të strukturave gjatësore të ujit përfshijnë:

- a) kodet e lumenjve;

- b) vendndodhjen;
- c) anët e bankinave;
- d) shënuesit kilometrikë;
- e) gjatësinë;
- f) vitin e ndërtimit;
- g) lartësinë në rrjedhën e sipërme dhe të poshtme;
- h) peshën e kurorës;
- i) shpatet e kanaleve ujore;
- j) shpatet e ledheve;
- k) qëllimi.

2.2 Tabela e attributeve të strukturave tërthore përfshin:

- a) kodin;
- b) vendndodhjen;
- c) llojin e objektit;
- d) vitin e ndërtimit;
- e) pronarin etj.

2.3 Të dyja tabelat e attributeve janë të lidhura me tabelat që përshkruajnë dokumentacionin teknik.

3. Shtresat gjeohapësinore dhe përshkrimet e tyre specifike janë:

a) Strukturat gjatësore të ujit, të tilla si: ledhet, pritrat për të shmangur përmytjet, pritrat për të shmangur intruzionin e ujit të detit janë përshkruar, sipas:

- i. emrit;
- ii. llojit të strukturës;
- iii. emërtimit të ujërave sipërfaqësore;
- iv. bankinave të lumit/bregdetit;
- v. gjerësisë;
- vi. gjatësisë;
- vii. fillimit të shënuesit kilometrik;
- viii. fundit të shënuesit kilometrik;
- ix. materialit të objekt ujq;
- x. lartësisë absolute në rrjedhën e sipërme të kurorës së objektit ujq;
- xi. lartësisë në rrjedhën e poshtme të kurorës së objektit ujq;
- xii. rëndësisë së kurorës së objektit lumq;
- xiii. shpateve të rrjedhës së ujit;
- xiv. pjesës së pasme të shpatit;
- xv. vlerës përkatëse të ujit për vlera të mëdha të rrjedhës ujore;
- xvi lartësisë së objektit hidroteknik mbi nivelin e ujit;
- xvii. lartësisë relative mesatare, në lidhje me nivelin e tokës përreth;
- xviii. gjerësisë mesatare të objektit ujq.

b) Strukturat gjatësore të ujit, të tilla si: ledhet, pritrat për të shmangur përmytjet, pritrat për të shmangur intruzionin e ujit të detit janë përshkruar sipas kushteve:

- i. vitit të ndërtimit;
- ii. vitit të rikonstuksionit të fundit;
- iii. qëllimit kryesor;
- iv. burimit të të dhënave gjeometrike;
- v. autoritetit mirëmbajtjes ID (numri i identifikimit).

c) Strukturat tërthore të ujit, të tilla si: diga, stacione pompimi, barriera, panelet mbrojtëse, kapërderdhësit, daljet nga shtrati për kanalet vaditëse janë përshkruar, sipas:

- i. emrit;
- ii. vendndodhjes;
- iii. gjerësisë;

- iv. gjatësisë;
- v. lartësisë;
- vi llojit të objektit ujqor.
- d) Strukturat tërthore të ujqit, të tilla si: diga, stacione pompimi, barriera, panelet mbrojtëse, kapërderdhësit, daljet nga shtrati për kanalet vaditëse janë përshkruar, sipas kushteve:
 - i. vitit të ndërtime;
 - ii. vitit të rikonstrukcionit të fundit.
- 4. Përveç të dhënave të përgjithshme, daljet nga shtrati për kanalet vaditëse janë përshkruar nga:
 - a) kapaciteti dalës;
 - b) volumi.
- 5. Përveç të dhënave të përgjithshme, plotat janë përshkruar nga:
 - a) lartësia e tyre maksimale mbi kurorë;
 - b) dimensionit të përhapjes së ujërave;
 - c) kapaciteti i plotës;
 - d) mundësia e ndotjes nga plota.
- 6. Përveç të dhënave të përgjithshme, stacionet e pompimit janë përshkruar nga:
 - a) rrjedha e ujqit në të cilën uji është lëvizur nëpërmjet stacionit të pompimit;
 - b) shënuesi kilometrikë në grykëderdhje;
 - c) mesatarja shumëvjeçare e ujqit hyrës;
 - d) mesatarja vjetore maksimale e ujqit hyrës;
 - e) mesatarja vjetore minimale e ujqit hyrës;
 - f) numri i pompave;
 - g) fuqia totale e pompave;
 - h) kapaciteti total i përgjithshëm i pompave;
 - i) niveli maksimal i ujqit;
 - j) lartësia maksimale e punës;
 - k) lartësia minimale e punës;
 - l) kapaciteti maksimal gravitacional i derdhjes;
 - m) orët e punës vjetore mesatare;
 - n) konsumi mesatar vjetor i energjisë elektrike;
 - o) konsumi mesatar vjetor i karburantit të lëngshëm;
 - p) fluksi minimal i hyrjes së ujqit;
 - q) fluksi maksimal i hyrjes së ujqit;
 - r) qëllimi kryesor i stacionit të pompimit.
- 7. Përveç të dhënave të përgjithshme, sifonet janë përshkruar nga:
 - a) gjatësia në plan në terren;
 - b) sipërfaqja mesatare e prerjes tërthore të sifonit;
 - c) forma e profilin kryq mesatar të sifonit;
 - d) vlera përkatëse e rrjedhjes;
 - e) lloji i objektit mbi sifon;
 - f) emri i objektit të sipër sifonit;
 - g) shënuesi i largësisë së sifonit pika e fillimit;
 - h) shënuesi i largësisë së objektit.

SHTOJCA 4

KËRKESAT PËR MODULIN PËR PËRDORIMIN E UJIT

1. Moduli për përdorimin e ujqit përbëhet nga shtresa gjeohapësinore, të cilat janë të lidhura me një tabelë respektive të attributeve. Tabelat e attributeve përmbajnë identifikues unik, kodet

kombëtare dhe të BE-së, emrat dhe përshkrimin e saktë të këtyre shtresave. Tabelat e attributeve janë të lidhura me dokumentacion teknik aty ku është e përshtatshme.

2. Shtresat gjeohapësinore të përdorimit të ujit dhe përshkrimet e tyre të veçanta janë:

- a) pikat e nxjerrjes së ujit;
- b) objektet dhe pikat hidroteknike;
- c) koncesionet dhe tarifat e koncesionit.

2.1 Pikat e nxjerrjes së ujit përshkruhen nga:

- a) të dhënat e përgjithshme;
- b) sasia e nxjerrë;
- c) emrit;
- d) vendndodhjes;
- e) gjerësisë;
- f) gjatësisë;
- g) lartësisë;
- h) vitit të rindërtimit;
- i) identifikimi i koncesionit (ID);
- j) llojit të objektit të ujit;
- k) vitit të ndërtimit;
- l) pellgut dhe nënpellgut ku ndodhet.

2.2 Sipas tipit nga ku nxirret uji:

- a) ujërat sipërfaqësore;
- b) ujërat nëntokësore;
- c) ujërat detare;
- d) të tjera.

2.3 Sipas llojit të marrjes:

- a) marrje në burim;
- b) puse;
- c) lumë;
- d) liqen apo grumbullime uji.

2.4 Sipas metodës së nxjerrjes së ujit;

- a) me pompë;
- b) rrjedhje e lirë;
- c) artezian;
- d) të tjera.

2.5 Sipas qëllimit të nxjerrjes së ujit:

- a) furnizimi publik me ujë;
- b) ujë për imbotilim;
- c) ujë mineral;
- d) ujë teknologjik;
- e) ujë për terapi shëndetësore;
- f) ujë rekreativ;
- g) ujë për ujitje;
- h) ujë për akuakulturë;
- i) ujë për nevojat blegtorale;
- j) ujë për hidroenergji;
- k) ujë për hidrocentrale;
- l) ujë për nevojat e zjarrfikësve;
- m) ujë për përdorim familjar.

2.6 Nga kapaciteti i pompës:

- a) kapaciteti i lejuar i nxjerrjes së ujit;
- b) kapaciteti i lejuar i veprës ose i pompës;

- c) nga kapaciteti i mundshëm shtesë për nxjerrjen e ujit.
- 2.7 Sipas thellësisë së zhytjes së pompës dhe viti i ndërtimit të pusit;
 - a) nga niveli i ujit;
 - b) nga viti i ndërtimit.
- 2.8 Sasia e nxjerrë është përcaktuar nga:
 - a) data e futjes së të dhënave;
 - b) viti dhe muaji i vënies në përdorim të pusit, kaptazhit;
 - c) shfrytëzimi i të gjithë muajve në total.
- 3. Objektet dhe pikat hidroteknike dhe të dhënat e tyre.
- 3.1 Objektet hidroteknike janë të përcaktuara sipas:
 - a) aktivitetit të objekteve hidroteknike;
 - b) identitetin (ID-në) e koncesionit;
 - c) emrit;
 - d) vendndodhjes;
 - e) gjerësisë;
 - f) gjatësisë;
 - g) lartësisë;
 - h) qëllimi i objektit hidroteknik;
 - i) sipas pellgut dhe nënpellgut ku është vendosur.
- 4. Koncesionet.
- 4.1 Koncesionet janë përshkruar sipas dokumentacionit fillestar:
 - a) identiteti i koncesionit;
 - b) ofruesi i koncesionit;
 - c) përdoruesi i koncesionit;
 - d) data e lëshimit.
- 4.2 Sipas qëllimit të koncesionit:
 - a) nxjerrjen e ujit për furnizimin të popullatës;
 - b) nxjerrjen e ujit - paketim me shishe;
 - c) nxjerrjen e ujit për nevoja teknologjike;
 - d) nxjerrjen e ujërave minerale dhe termale;
 - e) nxjerrjen e ujërave për terapi shëndetësore dhe rekreacion.
- 4.3 Sipas qëllimit të konsumit të ujit:
 - a) kullim;
 - b) ujitje;
 - c) përdorimi i fuqisë së ujit për impiante industriale;
 - d) përdorimi i ujit për të gjeneruar energji elektrike;
 - e) rrugëve ujore në brendësi dhe liqenet;
 - f) portet dhe kalatat;
 - g) akuakulturë.
- 4.4 Sipas përdorimit të ujit si pasuri publike:
 - a) sportive dhe rekreacioni;
 - b) sipas vendndodhjes së koncesionit;
 - c) sipas periudhës së koncesionit (vjet);
 - d) nga data e skadimit;
 - e) nga objekti i përdorimit;
 - f) dinamika e pagesës;
 - g) pagesa në kohë e tarifës;
 - h) përdorimi ekonomik dhe përdorime të tjera të ujit si pasuri publike.
- 5. Tarifat e koncesionit janë përshkruar në identitetin (ID-në) e koncesionit, sipas:
 - a) vitit të kontabilitetit;
 - b) sasisë;

- c) tarifës së faturimit;
- d) borxhit;
- e) tarifës në ngarkim;
- f) datës së pagesës.

SHTOJCA 5

KËRKESAT PËR MODULIN PËR MBROJTJEN E UJIT

1. Moduli për mbrojtjen e ujit përbëhet nga shtresa gjeohapësinore, të cilat janë të lidhura me tabelat përkatëse të attributeve. Tabelat e attributeve përmbajnë identifikues unikë, kodet (kombëtare dhe të BE-së), emrat dhe përshkrimin e saktë të këtyre shtresave. Tabelat e attributeve janë të lidhura me dokumentacion teknik aty ku është e përshtatshme.

2. Shtresat gjeohapësinore dhe përshkrimet e tyre të veçanta.

2.1 Pikat e ndotësve potencialë dhe të dhënat e përgjithshme. Ndotësit potencialë janë përshkruar nga agjencia përgjegjëse nga:

- a) emri;
- b) vendndodhja;
- c) vendndodhja e detajuar në përmasa me të kufizuara;
- d) gjerësia;
- e) gjatësia;
- f) lartësia;
- g) sektorët e aktivitetit;
- h) aktiviteti;
- i) informacionet shtesë;
- j) data e regjistrimit.

2.2 Sipas sasisë së ndotjes:

- a) data e përcaktimit;
- b) metoda e përcaktimit;
- c) grupi i ndotësve;
- d) njësia e matjes;
- e) sasia e ndotësit;
- f) përqendrimi i ndotësve;
- g) rrjedha;
- h) zonat e përhapjes.

SHTOJCA 6

KËRKESAT PËR MODULIN PËR ZONAT E MBROJTURA UJORE DHE HABITATET UJORE

1. Moduli për zonat e mbrojtura ujore përbëhet nga shtresa gjeohapësinore, të cilat janë të lidhura me tabelat përkatëse të attributeve. Tabelat e attributeve përmbajnë identifikues unikë, kodet (kombëtare dhe të BE-së), emrat dhe përshkrimin e saktë të këtyre shtresave. Tabelat e attributeve janë të lidhura me dokumentacion teknik aty ku është e përshtatshme.

2. Shtresat gjeohapësinore dhe përshkrimet e tyre të veçanta janë:

- a) zonat e mbrojtura dhe habitatet ujore;
- b) zonat e mbrojtura të zogjve;
- c) zonat e mbrojtura sanitare të burimeve ujore;
- d) zonat e mbrojtura atraktive dhe banjat;
- e) zonat e mbrojtura të lëndëve ushqyese sensitive;
- f) zonat e mbrojtura të specieve endemike të rëndësishme;
- g) fusha të tjera të zonave të mbrojtura.

2.1 Zonat e mbrojtura dhe habitatet ujore janë përshkruar, sipas:

- a) emrit;
- b) llojit të zonave të mbrojtura;
- c) gjatësisë;
- d) gjerësisë;
- e) zonës.

2.2 Zonat e mbrojtura të zogjve, janë përshkruar sipas:

- a) emrit;
- b) llojit të zonave të mbrojtura;
- c) gjatësisë;
- d) gjerësisë;
- e) zonës.

2.3 Zonat e mbrojtjes sanitare të burimeve ujore janë përshkruar, sipas:

- a) emrit;
- b) llojit të zonës së mbrojtur:
 - i. zona e parë e mbrojtjes ose zona e rreptësisë;
 - ii. zona e mbrojtjes së afërt;
 - iii. zona e mbrojtjes së largët;
- c) gjatësisë;
- d) gjerësisë.

2.4 Zonat e mbrojtura atraktive dhe banjat janë përshkruar, sipas:

- a) emrit;
- b) llojit të zonave të mbrojtura;
- c) gjatësisë;
- d) gjerësisë;
- e) zonës.

2.5 Zonat e mbrojtura të lëndëve ushqyese sensitive janë përshkruar, sipas:

- a) emrit;
- b) llojit të zonave të mbrojtura;
- c) gjatësisë;
- d) gjerësisë;
- e) zonës.

2.6 Zonat e mbrojtura të specieve endemike të rëndësishme janë përshkruar, sipas:

- a) llojit të zonave të mbrojtura;
- b) gjatësisë;
- c) gjerësisë;
- d) zonës.

2.7 Fusha të tjera të zonave të mbrojtura janë përshkruar, sipas:

- a) llojit të zonave të mbrojtura;
- b) gjatësisë;
- c) gjerësisë;
- d) zonës;
- e) hapësirës së vendndodhjes;
- f) llojit të zonave të mbrojtura në Shqipëri;
- g) kategorisë lokale;
- h) lejeve të lëshuara nga organet ligjvënëse.

SHTOJCA 7 KËRKESAT PËR MODULIN PËR MONITORIMIN E UJIT

1. Moduli për monitorimin e ujit përbëhet nga shtresa gjeohapësinore, të cilat janë të lidhura me tabelat përkatëse të attributeve.

2. Tabelat e attributeve përmbajnë identifikues unik, kodet (kombëtare dhe të BE-së), emrat dhe përshkrimin e saktë të këtyre shtresave, duke përfshirë seri kohore për ujërat nëntokësore dhe sipërfaqësore të të dhënave të monitorimit të ujit.

3. Tabelat e attributeve janë të lidhura me dokumentacion teknik aty ku është e përshtatshme.

4. Shtresa gjeohapësinore dhe karakteristikat e tyre të veçanta janë:

- a) stacionet matëse të cilësisë së ujit për ujërat sipërfaqësore;
- b) stacionet matëse të cilësisë së ujit për ujërat nëntokësore;
- c) karakteristikat e vlerësimit të cilësisë së ujit.

4.1 Monitorimi i ujërave nëntokësore është përshkruar:

- a) me emër;
- b) me gjerësi;
- c) me gjatësi;
- d) sipas ndarjes së kufirit të sipërm;
- e) sipas ndarjes së kufirit më të ulët;
- f) nga sasia;
- g) sipas funksionit;
- h) sipas mbikëqyrjes;
- i) sipas nivelit të thellësisë;
- j) sipas pusit apo burimit;
- k) nga një monitorim i vetëm;
- l) nxjerrja e ujit të pijshëm;
- m) furnizimi industrial;
- n) vaditja;
- o) furnizime të tjera.

4.2 Stacionet matëse të cilësisë së ujit janë përshkruar, sipas:

- a) etiketës origjinale;
- b) monitorimit të llojit të objektit;
- c) ujërave sipërfaqësore-lumenjve;
- d) ujërave sipërfaqësore-liqeneve;
- e) ujërat nëntokësore - burimet;
- f) ujërat nëntokësore - pus-shpimet;
- g) ujë nëntokësore - strukturat e gërmuara;
- h) ujërat nëntokësore - strukturat gjeomorfologjike;
- i) ujërat bregdetare;
- j) ujërat e ndotura.

4.3 Monitorimi i cilësisë së ujit karakterizohet, si:

- a) operacional;
- b) mbikëqyrës;
- c) referues;
- d) kërkimor;
- e) nga vetë pronari identifikues.

4.4 Karakteristikat e cilësisë së ujit përshkruhen, sipas:

- a) intervaleve të rregullta;
- b) të dhënave të rezultateve;
- c) matjeve;
- d) nxjerrjes;
- e) intervalit matës;
- f) datës së fillimit të matjes;
- g) datës së përfundimit të matjes;

h) vazhdimësisë së matjes.

5. Matja e cilësisë së ujit përshkruhet nga metodologjia, si:

- a) manuale;
- b) automatike.

6. Karakteristikat e matjes së të dhënave të kampioneve janë përshkruar:

- a) marrja në thellësi e kampioneve;
- b) kushtet hidrologjike;
- c) shkalla e rrjedhjes;
- d) niveli i ujit.

7. Parametrat kimikë dhe fizikë janë përshkruar nga:

- a) data e analizës;
- b) temperatura e ujit;
- c) temperatura e ajrit;
- d) era;
- e) shija;
- f) ngjyra;
- g) ndotja e ujit;
- h) përçueshmëria elektrike;
- i) mbetjet e thata;
- j) oksigjeni i tretur në ujë;
- k) ngopja me oksigjen.

7.1 Parametrat themelorë kimikë janë përshkruar nga:

- a) data e analizës;
- b) lënda pezull;
- c) mbetja e thatë;
- d) alkaliniteti total;
- e) alkaliniteti karbonat;
- f) alkaliniteti bikarbonat;
- g) fortësia e përgjithshme;
- h) fortësia e karbonatit;
- i) fortësia e kalciumit;
- j) fortësia magnezit;
- k) karbonatet;
- l) bikarbonatet.

7.2 Kationet dhe anionet bazë janë përshkruar nga:

- a) data e analizës;
- b) fluori;
- c) kloruret;
- d) sulfatet;
- e) silikatet;
- f) kaliumi;
- g) natriumi;
- h) kalciumi;
- i) magnezi;
- j) të tjera, sipas parametrave të bazuar në standardet e cilësisë së ujit të pijshëm në Shqipëri.

7.3 Parametrat mikrobiologjikë janë përshkruar nga:

- a) data e analizës;
- b) llogaritja e kolonisë në 37°C (N/100ml);
- c) llogaritja e kolonisë në 22°C (N/100ml); bakteret Koliformeenterokoki (N/100ml);
- d) Escherichia coli;
- e) Clostridium Perfringens(N/100ml).

7.4 Parametrat sanitarë dhe mikrobiologjikë janë përshkruar nga:

- a) data e analizës;
- b) organotropet aerobike;
- c) bakteret fekale 37°C (N/100ml);
- d) bakteret fekale 44°C (N/100ml);
- e) streptokokët fekalë;
- f) enterokoku i zorrëve; salmonela;
- g) bakteret në 37°C (N/ml);
- h) mikrobet;
- i) Coli;
- j) Escherichia coli;
- k) sulfatet;
- l) Clostridia e kuqe.

8. Stacionet e monitorimit të nivelit të ujërave nëntokësore janë përshkruar nga:

- a) niveli i stacionit (ID-ja) të monitorimit;
- b) stacionet (ID-ja) e monitorimit nëntokësor;
- c) emërtimi origjinal;
- d) identiteti (ID-ja) i pronarit.

9. Stacionet e monitorimit të ujërave sipërfaqësore dhe llojit të tyre, stacionet e matjes së cilësisë së ujit, dokumentacioni, stacioni i matjes së karakteristikave hidrologjike dhe pjesa kohore.

9.1 Stacionet e monitorimit të ujërave sipërfaqësore janë përshkruar nga:

- a) emri;
- b) gjerësia;
- c) gjatësia;
- d) gjendja e punës;
- e) vëzhgimet;
- f) investigimet;
- g) referencat;
- h) ndërkalibrimet.

9.1.1 Sipas llojit të ujit sipërfaqësor, në:

- a) ujë bregdetar;
- b) ujë i ndryshueshëm;
- c) i përkohshëm;
- d) lumë;
- e) liqen.

9.2 Stacionet matëse të cilësisë së ujit janë përshkruar nga:

- a) emërtimi origjinal;
- b) ID-ja e pronarit;
- c) llojet e monitorimit të cilësisë së ujit;
- d) objekti i monitorimit.

9.3 Të dhënat e stacioneve hidrologjike janë përshkruar nga:

- a) emërtimi origjinal;
- b) numri origjinal i stacionit;
- c) ID-ja e pronarit;
- d) lloji i stacionit hidrologjik;
- e) lartësia;
- f) numri i matjes në taban dhe tavan;
- g) shënuesit e largësisë.

9.4 Dokumentacionet janë përshkruar nga:

- a) përshkrimi i dokumentit;

- b) arkivi;
- c) numri arkivor;
- d) forma e dokumentit.

9.5 Karakteristikat e stacionit matës hidrologjik janë përshkruar nga:

- a) intervale të rregullta;
- b) të dhënat e rezultateve;
- c) matjet;
- d) prurjet;
- e) instrumentet matëse apo metodat;
- f) zona e vogël e kufizuar;
- g) zona më e madhe;
- h) rrjedhja e lirë;
- i) pajisjet ADCP;
- j) pajisje elektromagnetike;
- k) metoda mix;
- l) metoda e matjes së objektit;
- m) të tjera;
- n) intervali i matjes;
- o) data e fillimit të matjes;
- p) data e përfundimit të matjes;
- q) vazhdimësia e matjes.

9.6 Metodologjia e matjes, sipas ID-së së kërkuar të mbikëqyrësit është:

- a) manuale;
- b) automatike.

9.7 Seritë kohore tabelare të monitorimit janë përshkruar nga:

- a) data dhe koha;
- b) kapaciteti i rrjedhës;
- c) lartësia e matjes në taban dhe tavan;
- d) pasqyra e ujit;
- e) zona e ndotur;
- f) përqindja e rrjedhjes maksimale në profil;
- g) paraqitja kryesore e normës së rrjedhjes.

10. Monitorimi i ujërave sipërfaqësore të rrjetit është përshkruar, me:

- a) kodin e monitorimit të rrjetit: Eionet, Eurowaternet;
- b) vendimi 86/574/EEC - cilësia e ujit të freskët sipërfaqësor;
- c) direktivën 91/676/EEC - ndotja nga nitratat apo bujqësia;
- d) matjen e programeve të OECD (EMEP);

e) një pjesë të raportit në nivel baseni ujor të qarkut, të cilat nuk janë pjesë e rrjetit të monitorimit ndërkombëtar ose të panjohura.

SHTOJCA 8

KËRKESAT PËR MODULIN PËR MONITORIMIN METEOROLOGJIK

1. Moduli për monitorimin meteorologjik përbëhet nga shtresa gjeohapësinore, të cilat janë të lidhura me tabelat përkatëse të attributeve.

2. Tabelat e attributeve përmbajnë identifikues unik, kodet (kombëtare dhe të BE-së), emrat dhe përshkrimin e saktë të këtyre shtresave, duke përfshirë seri kohore me të dhënat meteorologjike.

3. Tabelat e attributeve janë të lidhura me dokumentacion teknik aty ku është e përshtatshme.

4. Shtresat gjeohapësinore dhe përshkrimet e tyre të veçanta janë:

- a) stacionet meteorologjike;

- b) karakteristikat e matjes;
- c) metodologjia e matjes;
- d) të dhënat në seritë kohore meteorologjike;
- e) dokumentacionet.

4.1 Stacionet meteorologjike janë përshkruar nga:

- a) numri origjinal i stacionit;
- b) emërtimi origjinal;
- c) koordinatat gjeografike x, y, z;
- d) vendndodhja;
- e) lartësia;
- f) gjerësia;
- g) lloji i stacionit meteorologjik;
- h) identiteti (ID-ja) i pronarit.

4.2 Karakteristikat matëse janë përshkruar nga:

- a) data e fillimit të matjes;
- b) data e përfundimit të matjes;
- c) intervalet e rregullta;
- d) të dhënat e rezultateve;
- e) matja e realizuar;
- f) prurja;
- g) intervali i matjes;
- h) vazhdimësia e matjes.

4.3 Metodologjia e matjes është:

- a) manuale;
- b) automatike.

4.4 Të dhënat në seritë kohore meteorologjike janë përshkruar nga:

- a) data;
- b) temperatura e ajrit;
- c) reshjet.

4.5 Dokumentacionet janë përshkruar nga:

titulli i dokumentit;
arkivi;
numri arkivor;
formati i dokumentit.

SHTOJCA 9

PËR HEDHJEN E TË DHËNAVE NGA BURIMI I DISPONIMIT TË TYRE NË KADASTRËN KOMBËTARE TË BURIMEVE UJORE

Kjo shtojcë ka për qëllim të japë përcaktimet kryesore për aktorët e përfshirë mbi mënyrën e hedhjes të të dhënave të disponuara për popullimin e Kadastrës Kombëtare të Burimeve Ujore bazuar në marrëveshjet midis Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore (AMBU) dhe institucioneve respektive sipas fushave të Kadastrës.

I. TREGUESIT E KADASTRËS SIPAS FUSHAVE

Treguesit e Kadastrës janë elementet e cilësuar në sistemin e hedhjes së të dhënave të Kadastrës dhe që do të përdoren për popullimin e saj, sipas fushave të mëposhtme:

1. Treguesit e ujërave sipërfaqësore (*Surface Water*)
 - a) Basene lumore, nënbasenet, ujëmbledhësit (*River basins, sub-basins, catchments and watersheds*);
 - b) Liqenet dhe segmentet liqenore (*Lake and lake segments*);
 - c) Lumi, zona të lumit apo segmente të kanalit (*River, river or canal segment areas, river or canals segments*);

- d) Njësitë kalimtare të ujit (*Transitional Water units*);
- e) Njësitë bregdetare të ujit (*Coastal water units*);
- f) Ujërat territoriale (*Territorial water*).
- 2. Ujërat nëntokësorë (*Groundwater*)
 - a) Pikat e burimeve natyrore dhe të dhënat e përgjithshme të burimeve natyrore (*Spring points and spring general data*);
 - b) Pikat e shpimeve, të dhënat e përgjithshme, të dhënat hidrogeologjike, litologjike dhe dokumentet (*Borehole points, general data, hydrogeological data, lithology and documents*);
 - c) Pikat e gërmuara, të dhënat e përgjithshme për gërmimet, të dhënat hidrogeologjike dhe dokumentacioni (*Dug points, dug general data, hydrogeological data and documentation*);
 - d) Pikat geomorfologjike, të dhënat e përgjithshme dhe dokumentacioni (*Geomorphological points, general data and documentation*);
 - e) Njësitë e ujërave nëntokësore dhe njësitë e inerteve nëntokësore (*Groundwater units and aggregated groundwater unit*).
- 3. Monitorimi (*Monitoring*)
 - a) Monitorimi i ujërave nëntokësore, stacionet matëse të cilësisë së ujit, karakteristikat matëse të cilësisë së ujit, karakteristikat e matjes së të dhënave të kampioneve (*Groundwater monitoring, water quality measuring stations, water quality measuring characteristics, measuring characteristics sample data*);
 - b) Stacionet e monitorimit të ujërave sipërfaqësore, stacionet matëse të cilësisë së ujit, dokumentacioni, karakteristikat e stacionit matës hidrologjik, seritë kohore tabelare të monitorimit (*Surface monitoring stations, water quality measuring stations, documentation, hydrology station measurement characteristics, time series*);
 - c) Stacionet meteorologjike (*Meteorological stations*);
 - d) Karakteristikat matëse meteorologjike (*Meteorological measurement characteristics*).
- 4. Mbrojtja e ujit (*Water protection*).
 - a) Pikat e ndotësve potencialë dhe të dhënat e përgjithshme (*Potential pollutants points and general data*);
 - b) Sasia e ndotjes (*Amount of pollution*);
 - c) Zonat e habitateve të mbrojtura (*Habitat protected area*);
 - d) Zonat e mbrojtura të zogjve (*Bird protected area*);
 - e) Zonat e mbrojtura sanitare të burimeve ujore (*Drinking water protected area*);
 - f) Zonat e mbrojtura atraktive dhe banjat (*Recreation and bathing protected area*);
 - g) Zonat e mbrojtura të lëndëve ushqyese sensitive (*Nutrient sensitive protected areas*);
 - h) Zonat e mbrojtura të specieve endemike të rëndësishme (*Endemic significant species protected area*);
 - i) Fusha të tjera të zonave të mbrojtura (*Other protected area areas*).
- 5. Përdorimi i ujit (*Water usage*).
 - a) Pikat e nxjerrjes së ujit - të dhënat e përgjithshme, sasia e nxjerrë (*water abstraction points - general data, abstraction quantity*);
 - b) Objektet dhe pikat hidroteknike (*Hydrotechnical object points and data*);
 - c) Konkensionet, tarifat e konkensioneve (*Concessions, concessions fee*).
- 6. Struktura e ujit (*Water structure*).
 - a) Strukturat gjatësore të ujit (shpatet e ledheve, anët e bankinave, rregulloret) (*Longitudinal water structures (levee, floodwall, regulation)*).
 - b) Strukturat tërthore të ujit (prita/diga, stacione pompimi, barrierat, daljet nga shtrati, kapërderdhësit) (*Transversal Water structure (dam, pumping station, weir, overflow, outlet)*).
- 7. Topografia dhe toka (*Topographic & land*).
 - a) Të dhëna për përdorimin e tokës, gjeologjike dhe hipsometrike (*Land-use, geological and hypsometric data*);
 - b) Kufijtë administrativë (*Administrative boundaries*);
 - c) Qytetet (*Cities*);

- d) Kufijtë e shtetit (*State boundaries*);
- e) Autoritetet kompetente (*Competent Authorities*).

II. INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE PËR HEDHJEN E TË DHËNAVE SIPAS FUSHAVE TË TREGUESVE TË KADASTRËS

Për popullimin e sistemit të Kadastrës, me të dhënat e treguesve të cilësuar të sistemit të Kadastrës, do të aktivizohen institucionet relevante të hedhjes dhe përditësimit të të dhënave që disponohen në arkivat respektivë të tyre, që kanë lidhje me treguesit specifikë dhe që janë përcaktuar në dispozitën përkatëse për të populluar Kadastrën me këto të dhëna. Institucionet referuese, sipas fushave, janë si më poshtë vijon:

1. Ujërat sipërfaqësore (*Surface water*)

Për treguesit e fushës së ujërave sipërfaqësore, sipas nëntreguesve të saj të shprehura në pikat 1.a, 1.b, 1.c, 1.d, 1.e, 1.f të kreut I, të kësaj shtojce, ngarkohet AMBU-ja për hedhjen dhe përditësimin e të dhënave respektive, duke u bazuar në përcaktimet e trupave ujorë të identifikuar dhe kufizuar në planet e menaxhimit të baseneve ujore.

2. Ujërat nëntokësore (*Groundwater*)

Për treguesit e fushës së ujërave nëntokësore, sipas nëntreguesve të saj të shprehura në pikat 2.a, 2.b, 2.c të kreut I, të kësaj shtojce, ngarkohet AMBU-ja dhe Shërbimit Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) për hedhjen dhe përditësimin e të dhënave respektive, duke u bazuar në përcaktimin e trupave ujorë nëntokësorë të identifikuar dhe kufizuar në planet e menaxhimit të baseneve ujore. Për treguesit e fushës së ujërave nëntokësore, sipas nëntreguesve të saj të shprehura në pikat 2.d dhe 2.e të kreut I, të kësaj shtojce, ngarkohet Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) për hedhjen dhe përditësimin e të dhënave respektive për gjeomorfologjinë dhe vendndodhjen e trupave ujorë nëntokësorë, bazuar në dokumentacionin e përzgjedhjes së këtyre trupave, sipas kërkesave të Direktivës së Ujërave Nëntokësore dhe legjislacionit kombëtar në lidhje me ujërat nëntokësore.

3. Monitorimi (*Monitoring*)

Për treguesit e fushës së monitorimit të nëntreguesve të trupave ujorë nëntokësorë, të shprehur në pikën 3.a të kreut I, të kësaj shtojce, ngarkohet institucioni i SHGJSH-së ose/dhe institucioni që do të përcaktohet me marrëveshje nga AMBU-ja, për të zbatuar programin e monitorimit të ujërave nëntokësore (të përcaktuar me VKM-në respektive), të hedhin dhe të përditësojnë të dhënat e monitorimit të sasisë dhe cilësisë së ujërave nëntokësore.

Për treguesit e fushës së monitorimit të nëntreguesve të trupave ujorë sipërfaqësorë, të shprehur në pikën 3.b, të kreut I, të kësaj shtojce, ngarkohet Agjencia Kombëtare e Mjedisit, Instituti i Shëndetit Publik, Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës-Kanalizime dhe Mbetjeve të Ngurta, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura, Instituti i Gjeoshkencave, Energjisë, Ujërave dhe Mjedisit, Fakulteti i Shkencave Natyrore ose institucionet që do të përcaktohen me marrëveshje nga AMBU-ja, për të zbatuar programin e monitorimit të ujërave sipërfaqësore (të përcaktuar me VKM-në respektive), të hedhin dhe të përditësojnë të dhënat e monitorimit të sasisë dhe të cilësisë së ujërave sipërfaqësore.

Për treguesit e fushës së monitorimit të nëntreguesve të stacioneve meteorologjike dhe karakteristikave të matjeve meteorologjike të shprehur në pikat 3.c dhe 3.d të kreut I të kësaj shtojce, ngarkohet institucioni i IGJEUM-it, i SHMU-së, administratorët e HEC-ve ose/dhe institucioni që do të përcaktohet me marrëveshje nga AMBU-ja, për të zbatuar programin e monitorimit meteorologjik, në mbështetje të menaxhimit të burimeve ujore, të hedhin dhe përditësojnë të dhënat e monitorimit meteorologjik në Kadastrë.

4. Mbrojtja e ujit (*Water protection*)

Për treguesit e fushës së mbrojtjes së burimeve ujore dhe të nëntreguesve respektivë, të shprehur në pikat 4.a, 4.b, 4.c, 4.d, 4.e, 4.f, 4.g, 4.h, 4.i të kreut I të kësaj shtojce, ngarkohet AKZM-ja ose/dhe institucioni që do të përcaktohet me marrëveshje nga AMBU-ja, të hedhë dhe përditësojë të dhënat e burimeve ujore brenda zonave të mbrojtura natyrore, bazuar në

identifikimin dhe kufizimin e tyre, sipas planeve të menaxhimit të zonave të mbrojtura natyrore dhe në përputhje me planet e menaxhimit të baseneve ujore.

5. Përdorimi i ujit (*Water Usage*)

Për treguesit e fushës së përdorimit të burimeve ujore dhe të nëntreguesve të trupave ujorë, të shprehur në pikat 5.a, 5.b, 5.c të kreut I, të kësaj shtojce, ngarkohet AMBU-ja, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore dhe Korporata Elektroenergjetike Shqiptare, të hedhin dhe të përditësojnë të dhënat e përdoruesve të burimeve ujore, sipas qëllimit të përdorimit dhe bazuar në planet e menaxhimit të baseneve ujore.

6. Struktura e ujit (*Water structure*)

Për treguesit e fushës së strukturës së burimeve ujore dhe të nëntreguesve të trupave ujorë, të shprehur në pikat 6.1 dhe 6.2 të kreut I të kësaj shtojce, ngarkohen Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural (përfshirë institucionet e varësisë) dhe bashkitë, të hedhin dhe të përditësojnë të dhënat e strukturës së ujërave, sipas vendndodhjes së tyre dhe qëllimit të ndërtimit të këtyre strukturave në hapësirën gjeografike të baseneve ujore.

7. Topografia dhe toka (*Topographic & land*)

Për treguesit e fushës së topografisë dhe të kufizimit gjeohapësinor dhe të nëntreguesve respektivë të burimeve ujore, të shprehur në pikat 7.a, 7.b, 7.c, 7.d, 7.e të kreut I të kësaj shtojce, ngarkohet AMBU-ja në bashkëpunim me ASIG-un, të hedhin dhe të përditësojnë të dhënat e topografisë dhe kufizimit gjeohapësinor të burimeve ujore.

III. STANDARDET E GJENERIMIT TË TË DHËNAVE SIPAS FUSHAVE TË KADASTRËS

Treguesit e sistemit të Kadastrës janë të dhëna që gjenerohen nga institucionet respektive, sipas fushave të përcaktuara në kadastrë, si dhe në përputhje me standardet që janë përcaktuar në Programet Kombëtare të Monitorimit të ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore, të programit të monitorimit të elementeve hidrologjike dhe meteorologjike, si dhe në planet e menaxhimit të baseneve ujore dhe të zonave të mbrojtura brenda baseneve ujore.

IV. FREKUENCA E PËRDITËSIMIT TË TË DHËNAVE NË KADASTRËS

1. Frekuenca e përditësimit të të dhënave “statike”, që lidhen me fushat: ujërat sipërfaqësore, ujërat nëntokësore, koordinimi i stacioneve të monitorimit, mbrojtja e ujit, përdorimi i ujit, strukturat e ujit dhe topografia dhe toka (*surface water, groundwater, coordinations of monitorin stations, water protection, water usage, water structure and topographic & land*), është sipas periudhave kohore të përcaktuara në përputhje me kohën e rishikimit të planeve të menaxhimit të baseneve ujore, planeve të menaxhimit të zonave të mbrojtura, të periudhës së vlefshmërisë së të dhënave për përdoruesit e ujërave dhe strukturave të ndërtuara në burimet ujore, sipas planeve të shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së tyre.

2. Frekuenca e përditësimit të të dhënave të monitorimit të sasisë dhe të cilësisë së trupave ujorë nëntokësorë dhe sipërfaqësorë e të treguesve meteorologjikë dhe hidrologjikë do të përcaktohen nga programet kombëtare të monitorimit të ujërave nëntokësore dhe sipërfaqësore dhe të elementeve meteorologjike dhe hidrologjike të miratuara për burimet ujore dhe që do të përcaktohen në marrëveshjet për popullimin me të dhëna të Kadastrës midis AMBU-së dhe institucioneve respektive të gjenerimit të këtyre të dhënave.